ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 701-22-1340-1-1-1

Sa i përket tenderit për **Furnizim me reagense për Imunologji, gaztore dhe elektrolite**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SWISSMED SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Tirana, Nr. 42
(Adresa)

Prishtinë ***(Vendi)*** *10000* ***(Kodi postar)***

+383 49 891880 ***(Numri Telefonit)*** ***(Numri i Faks-it)***

Shpëtim Halili
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpetim.halili@swissmed-ks.com
ardi.behluli@swissmed-ks.com

(Adresa elektronike)

02.06.2022
(Data e parashtrimit të ankesës)

NRF:810819287 Nr.TVSH:330171265 SH.P.K SWISSMED PRISHTINË

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftim per Kontratë është publikuar me datë 02.03.2021 *Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 24.03.2022* *Vendim i Autoritetit Kontratktues: 10.03.2022* *Ankesa ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues: 14.03.2022* *Vendimi i Autoritetit Kontraktues për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit: 11.05.2022* *Kërkesa për Rishqyrtimin e Vendimit per heqjen e pezullimit:13.05.2022* *Vendimi për Refuzimin e Kërkesë për Rishqyrtim: 23.05.2022*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 112 i LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në datë 2 mars 2022, Autoriteti i Kontraktor (AK) pulbikoi njoftimin për kontratë në aktivitetin e prokurimit 701-22-1340-1-1-1. Duke qënë të interesuar për të marrë pjesë në këtë aktivitet, ne si Operatori Ekonomik Swissmed Sh.p.k. konstatuam se në fakt kushtet e pjesëmarjes ishin dizenjuar në një mënyrë të tillë që përjashtonin të gjithë operatorët

ekonomikë përveç njërit, duke e bërë në fakt këtë aktivitet prokurimi të paracaktuar. Prandaj dorëzuam tek AK një Kërkësë për Rishqyrtim në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Në datë 10 mars 2022 AK e refuzoi Kërkesën tonë për Rishqyrtim me anë të një Vendimi, për të cilin ne dorëzuam Ankesë në OSHP në datë 14 mars 2022. Në përputhje me LPP dorëzimi i Ankesës automatikisht (*ex lege*) solli si pasojë edhe pezullimin e aktivitetit të prokurimit. OSHP nuk ka vendosur ende lidhur me ankesën tonë. Megjithatë, në datë 11 maj 2022 AK publikon një Vendim të çuditshëm mbi heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit. Natyrisht që menjëherë e brenda afatit ligjor, në datë 13.05.2022 dorëzuam një kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit mbi heqjen e pezullimit. Në atë kërkesë parashtronim qartë argumentet ligjore për paligjshmërinë e vendimit të AK. Neni 112, paragrafi 1 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) parashikon: "***Përveç nëse paneli përkatës shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përderisa ta nxjerrë këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë".***
Pra LPP e përcakton qartë se aktiviteti i prokurimit pezullohet prej AK prej momentit kur dorëzohet Ankesa në OSHP derisa kjo e fundit të vendosë ndryshe me anë të një vendimi me shkrim. Në aktivitetin e prokurimit me numër 701-22-1340-1-1-1 nuk ka ende asnjë vendim me shkrim nga OSHP, as për heqjen e pezullim e as për diçka tjetër. I vetmi rast ku ligji parashikon një përjashtim nga rregulli i mësipërm është situata e parashikuar në paragrafin 2 të nenit 112 të LPP. Në këtë rast ligji autorizon kryetarin e OSHP-së që në rrethana të përcaktuara, sipas një procedure të përcaktuar duke dëgjuar edhe opinionin e ankuesit, të marë në raste të jashtëzakonshme vendim për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit. Pra në asnjë rast LPP nuk autorizon askënd përtej dhe jashtë OSHP që të vendosë lidhur me heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit pasi dorëzohet Ankesa në OSHP. AK nuk ka në asnjë rast autorizim ligjor për heqjen e pezullimit pas dorëzimit të Ankesës në OSHP. Vendimi i menaxherit të prokurimit i datës 11.05.2022 për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit është kësisoj i paligjshëm dhe në shkelje të hapur të nenit 112 të LPP.
Autoriteti Kontraktues është një organ adminstrativ publik e si i tillë subjekt i Ligjit për Procedurën Administrative (Ligji nr. 05/L-031). Në neni 52, paragrafi 1 i këtij ligji parashikohet paligjshmëria e një akti administrativ kur është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj. Anulimi i këtij akti, sipas nenit 54 po aty, është i detyrueshëm. Pra sipas dispozitave të mësipërme të Ligjit për Procedurën Administrative të pëmendura më sipër Vendimi i datë 11.05.2022 për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit është jo vetëm i paligjshëm, por duhet detyrimisht i anulueshëm prej Autoritetit Kontraktues.
Për më tepër, vendimmarrja e AK e datës 11.05.2022 mund të përbëjë gjithashtu edhe objekt të veprimtarisë së organeve ligjzbatuese si një prej veprave të parashikuara nën kapitullin XXXIII të Kodit Penal.
Megjithatë AK, në datë 23.05.2012 vendosi refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim. Arsyetimi i refuzimit është si më poshtë: "***Bazuar në afatet ligjore të parapara me dispozitat e LPP-së për trajtimin e kësaj ankese ku afati ligjorë ka skaduar, për nxjerrjen e VENDIMIT nga ana e Panelit Shqyrtues te OSHP-së, zyrtari përgjegjës i prokurimit ZPP e hekë masën e pezullimit sipas rregullave të parapara me LPP".*** AK në mungesë të plotë të seriozitetit më minimal për një organ administrativ, i jep vetes të drejtën jo vetëm që të përcaktojë afatet për trajtimin e një ankese nga OSHP, por edhe të dënojë mosrespektimin e pretenduar të këtyre afateve nga organi më i lartë i shqyrtimit të prokurimit në Kosovë. AK nuk përmend asnjë afat, asnjë dispozitë ku parashikohet ky afat, por thjesht "dispozitat e LPP-së". Së pari nuk i përket AK-së as të përcaktojë, por as të konstatojë se afatet ligjore për nxjerrjen e vendimit nga OSHP janë tejkaluar, AK është thjesht palë përpara OSHP-së në një konflikt ku OSHP është organi i vetëm i përcaktuar me

ligj për vendimmarrje. Nëse AK ka konsiderata lidhur me respektimin e afateve nga organi që shqyrton pikërisht paligjshmërinë e vendimmarrjes së AK-së, atëherë në një shtet të së drejtës adresa e vetme për të kërkuar respektimin e këtyre afateve do të ishte gjykata. Edhe nëse do ishte i bazuar pretendimi për tejkalimin e ndonjë afati, ligji në asnjë gërmë nuk parashikon të drejtën e AK-së për heqjen e pezullimit të aktivitetit. Përkundrazi, një veprim i tillë përbën thjesht dhe vetëm vetëgjyqësi të papajtueshme me parimet e sundimit të ligjit e të dënueshme në një shtet të së drejtës. I vetmi organ i mandatuar nga ligji – neni 112 i LPP - për të hequr pezullimin është OSHP. Vendimi i datës 13 maj 2022 për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit përbën jo vetëm një shkelje të rëndë ligjore nga ana e AK, por një akt të paprecedentë të dhunimit të ligjit me arrogancë nga një organ administrativ, duke përçudnuar themelet e sundimit të ligjit.

Lidhur me zbtimin e nenit 118 të LPP gjeni bashkëlidhur dëshminë e pagesës së tarifës për Ankesë të datë 14 mars 2022. Kjo Ankesë dorëzohet pikërisht për tëmundësuar shqyrtimin ligjor të Ankesë dorëzuar në datën 14.03.2022, pa të cilën nuk do të ekzistonte. Duke qënë se kjo ankesë është derivat dhe në funksion të shqyrtimit të Ankesës së dorëzuar në OSHP në datë 14.03.2022, për të cilën është paguar tarifa e ankimimit sipas nenit 118 të LPP, kësaj Ankese i bashkëlidhim dëshminë e pagesës së datës 14.03.2022.

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë që:

KËRKESË

- **OSHP TË ANULOJË Vendimin e paligjshëm të AK për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me reagensë për Imunologji, gaztore dhe elektrolite" dhe numër prokurimi 701-22-1340-1-1-1**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) Një kopje e vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
c) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
d) Opinioni i Ekspertit Shqyrtues Nr. 540/21, datë 16.07.2021

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*